



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT BESNIK DOKUSHI



VENDIM

(Për caktimin e vlerës së sendit të paluajtshëm dhe shpalljen e shitjes në ankandin e dytë)

Unë, Përmbaruesi Gjyqësor Privat Besnik DOKUSHI, në referim të Urdhërit të ekzekutimit Nr.14230 Akti, datë 28.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, me kërkesën e kreditorit Banka Credins sh.a, ndaj debitorit Shoqëria "G&O Trading" sh.a me NIPT L32207034U në lidhje me titullin Kontratë Kredie Afatgjatë, Nr.6596, Nr.946 Rep. Nr.554 Kol, datë 29.10.2020 lidhur midis Banka Credins sha në cilësinë e kredidhënësit, Shoqëria "G&O Trading" sh.a me NIPT L32207034U në cilësinë e kredimarrësit dhe të garantuesit hipotekor për efekt të garantimit të kredisë së sipërpërmendur. Me përmbushjen konform ligjit të të gjitha hapave të parashikuara dhe të kërkuara procedurale, si dhe me përfundimin e afatit të fundit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm parashikuar në nenin 567 të K.Pr.Civile.

KONSTATOVA:

Se, debitori Shoqëria "G&O Trading" sh.a me NIPT L32207034U nuk i është përgjigjur detyrimit kundrejt kreditorit Credins Bank sh.a, si dhe të gjitha njoftimeve të cilat i janë bërë me dije nga Përmbaruesi Gjyqësor.

Lidhur sa më sipër, referuar nenit 568, 570 të K.Pr.Civile, si edhe Ligjit Nr. 26/2019, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" dhe Udhëzimit Nr.385/7 datë 28.06.2017 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat"

VENDOSA:

1. Të shpall ankandin e dytë për shitjen e pasurisë së paluajtshme të lënë kolateral:

- Pasuria me Nr.536, Vol 6 faqe 91 e ndodhur në Zonen Kadastrale nr.1058, e llojit "Pemtore" me sip. 103.3 HA me adresë : Asim Zeneli, Gjirokastër. në pronësi të Shoqëria "G&O Trading" sh.a me NIPT L32207034U.

Cmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 404,936,000 (katërqind e katërmilion e nënëtdëqind e tridhjetë e gjashtëmijë)Leke

2. Ankandi do të qendrojë i publikuar nga data 15.11.2022 deri në datë 14.12.2022 dhe zhvillohet në këtë datë në përfundim të orarit zyrtar (ora 16:00).

3. Secili ofrues duhet të depozitojë bashkë me kërkesën për pjesmarrjen në ankand edhe garancinë prej 10% të cmimit fillestar në llogarinë bankare të Personit Fizik pranë pranë "Credins Bank" sh.a me nr. **Llogarisë 00001678898 dhe IBAN AL40 2121 1009 0000 0000 0167 8898.**

4. Publikimi i këtij ankandi kryhet konform nenit 568 të K.Pr.Civile.

5. Tarifa për organizimin dhe shitjen e sendit në ankand sipas Udhëzimit Nr.385/7 datë 28.06.2017 është e barabartë me shumën e 2 pagave bazë minimale mujore.

6. Ky vendim i komunikohet palëve të cilët kundër tij kanë të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditësh në Gjykatë.

PERMBARUESI GJYQËSOR
BESNIK DOKUSHI

